

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët–Valdete Daka, kryetare, Nesrin Lushta e Avdi Dinaj-anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit V. J. nga komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178.lidhur me nenin 28.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.547/2013 të datës 13.03.2014. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.372/2014 të datës 16.02.2016., në seancën e mbajtur më 01.11.2016., mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si të pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit V. J. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.547/2013 të datës 13.03.2014. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.372/2014 të datës 16.02.2016.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.547/2013 të datës 13.03.2014. i dënuari V. J. është shpallur fajtor për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 178.lidhur me nenin 28.të KPK dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muaj, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në

paraburgim prej datës 24.05.2013. deri më datën 06.08.2013. dhe në arrest shtëpiak prej datës 06.08.2013. deri më datën 26.09.2013. Me të njëjtin aktgjykim i dënuari M. Sh. është shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188.par.1. nënpar.1.1.të KPK dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €, të cilin është obliguar të paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e në rast të mospagimit i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur 20 € për një ditë burgimi. Të dënuarit janë obliguar të paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor. Me këtë aktgjykim, i pandehuri E. S. është liruar nga akuza për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188.par.1. nënpar.1.1.të KPK dhe është vendosur që në këtë pjesë shpenzimet e procedurës penale bijnë në barë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në procedurën ankimore me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.372/2014 të datës 16.02.2016. është vendosur që me pranimin e pjesëshëm të ankesës së Prokurorit Themelor në Gjilan aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet përkritazi me të dënuarin V. J., sa i përket vendimit për dënimin ashtu që për veprën për të cilën është shpallur fajtor është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, ndërsa në pjesën tjetër ankesat e ushtruara janë refuzuar si të pabazuara dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari V. J. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.185/16 të datës 06.10.2016. ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e pabazuar.

Pretendimet për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës

Në kërkesën për mbrojtjen e ligshmërisë pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.1.pika 12.të KPPK sepse aktgjykimi i shkallës së parë është i pakuptueshëm, kundërthënës me brendinë e vet, nuk përmban arsye për faktet vendimtare ndërsa arsyet që janë dhënë janë të paqarta dhe kundërthënëse e sidomos për përmbajtjen e deklaratave të dëshmitarëve, provave materiale dhe shkresat tjera të lëndës, gjendja faktike nuk mbanë korrespondencë me gjendjen reale të ndodhisë të ditës kritike, për çka konkludimet e nxjerra nga gjykata janë jo të drejta dhe jo ligjore.

Megjithatë, në kërkesën për mbrojtjen e ligshmërisë nuk është shpjeguar se si manifestohen të gjitha këto mangësi, por ceket se nga deklaratat e dëshmitarëve prezent, rezulton se që nga fillimi i ngjarjes kritike i dënuari V. J. ka qenë i sulmuar nga i dënuari M. Sh., e ky sulm ka qenë i paprovokuar, i atëçastshëm dhe serioz, ashtu që ka pësuar edhe lëndime trupore dhe të gjitha veprimet të cilat i ka ndërmarrë kanë qenë të orientuar dhe të ndërmarr me qëllim të zbrapsjes së sulmit të tillë.

Gjykata Supreme konstaton se nga aktgjykimi i shkallës së parë dhe nga shkresat e lëndës rezulton se nga mbrojtjet e të dënuarve dhe provat e administruara, në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar se para ngjarjes kritike të dy të dënuarit kanë qenë në vendin e ngjarjes, i dënuari V. J. në automjetin e udhëtarëve të cilin e ka drejtuar dëshmitari R. A. e në të cilin kanë qenë edhe dëshmitarët E. N. dhe K. R., ndërsa i dënuari M. Sh. ka qenë në autobus i cili ka qarkulluar në drejtimin e kundërt me automjetit. Po ashtu nuk ka qenë kontestuese se për shkak të bllokimit të komunikacionit, i dënuari M. ka dal nga autobusi dhe ka kërkuar nga dëshmitari R. që të lëvizë dhe të mundësojë kalimin e autobusit e më pastaj me grusht i ka ra automjetit, nga i cili ka dal i dënuari V.

Për atë se çka ka ndodhur më pastaj, i dënuari V. ka deklaruar se është ndier keq prej veprimeve të dënuarit M. dhe prej sharjeve të cilat kanë pasur, ka dal duke i thënë se nuk kanë pas se ku të largohen, nga autobusi ka dal shoferi M. S. e ka kapur për krahu dhe ia ka shqyer këmishën, pastaj i dënuari M. e ka goditur me grusht te vetulla dhe shumë njerëz kanë dal nga autobusi dhe kanë filluar te sulmojnë, ashtu që në këtë situatë ai e ka nxër briskun dhe në vetëmbrojtje ka sjellë djathtas-majtas e horizontalisht, nuk është shtrirë për toke dhe e ka humbur vet dijen.

Përmbajtja e provave tjera ka qenë si në vijim:

Dëshmitari R. A. ka deklaruar se pasi i dënuari V. ka dal nga automjeti, i dënuari M. atë menjëherë e ka sulmuar me grushta dhe ai nuk ka mundur të sheh veprimet e të dënuarit V. sepse nga autobusi kanë dal disa persona dhe e kanë kap V., e kanë gjuajtur mbi haubë të automjetit, ai pastaj ka rra në tokë dhe këta njerëz i kanë rra me grushta dhe shqelma. Për më tepër, kanë tentuar te gjuajnë në lum, por kanë qenë të penguar.

Dëshmitari K. R. ka deklaruar se pasi i dënuari V. ka dal nga automjeti dhe pas sharjeve nga i dënuari M., nga autobusi ka dal vozitësi-dëshmitari M. Sh. i cili po ashtu e ka sha të dënuarin V., ka filluar përleshja në të cilën i dënuari M. i ka ra me grusht në fytyrë të dënuarin V., atë e kanë rrah edhe shumë persona tjerë ashtu që është shtrirë për tokë e më pastaj e kanë dërguar në shtëpinë e shëndetit. Kështu ka deklaruar edhe dëshmitari E. N.

I pandehuri E. S. ka deklaruar se pas konfrontimit në mes të dëshmitarit R. dhe të dënuarit M., nga dera e pasme e automjetit ka dal i dënuari V. me thikë apo brisk ne dorë dhe i pandehuri E. bashkë me një person tjetër e kanë kthyer në veturë dhe e kanë qetësuar situatën por menjëherë pastaj i dënuari V. prapë ka dal nga vetura dhe ka dëgjuar se dikush ka bërtite “e theri, e theri”.

I dënuari M. Sh. ka thënë se sharjet kanë ndodhur në mes tij dhe dëshmitarit R. A. dhe kur vëllai i tij E. e ka larguar nga vetura, nga vetura ka dal i dënuari V. dhe me brisk

patent e ka qëlluar nëpër pjesë të ndryshme të trupit 6 here duke i shkaktuar lëndime trupore.

Nga ekspertiza mjekësore është vërtetuar se në këtë ngjarje i dënuari M. Sh. ka pësuar tri plagë shpuese në regionin e majtë të gjoksit dhe një plagë prerëse shpuese në shpatullën e majtë, të cilat kanë qenë të natyrës së rënd trupore dhe me pasoja të përhershme për shëndetin, ndërsa i dënuari V. J. plagë shqyese ndrydhëse mbi syrin e majtë, ndrydhje të indeve të buta në regionin e kokës dhe gërvishje në regionin e dorës së majtë, lëndime këto të natyrës së lehtë trupore.

Përmbajtja e të gjitha këtyre provave është dhënë në aktgjykimin e shkallës së parë. Ato janë vlerësuar secila veç e veç dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, siç kërkohet me dispozitën e nenit 361.par.2.të KPPK dhe gjykata në bazë të vlerësimit të tyre ka nxjerr përfundim nëse faktet relevante janë provuar apo jo. Me këtë rast në mënyrë të qartë dhe të plotë janë dhënë arsyet për provat kundërthënëse dhe për kredibilitetin e deklaratave të dhëna në procedurën e shkallës së parë. Konkludimi i gjykatës së shkallës së parë ka qenë se nuk është e bazuar mbrojtja e të dënuarit V. J. se veprimet inkriminuese i ka ndërmarr për ta zbrapsur sulmin e atëçastshëm dhe kundërligjor e të dënuarit M. Sh., siç detajisht është shpjeguar në faqet 12,13 dhe 14 të aktgjyimit të shkallës së parë. Gjykata Supreme i pranon si të ligjshme arsyet e këtij aktgjykimi se edhe pse edhe i dënuari V. ka pësuar një goditje në fytyrë nga i dënuari M., veprimet e tij nuk janë të ndërmarra në mbrojtje të nevojshme, sepse konflikti paraprak ka qenë në mes dëshmitarit R. dhe të dënuarit M., ndërsa i dënuari V. ka dal nga vetura edhe pse sharjet nuk kanë qenë të drejtuara atij, dhe me brisk e ka qëlluar të dënuarin M. Duhet të shtohet se vet i dënuari V. nuk ka deklaruar se sulmi me grusht nga i dënuari M. ka qenë i atëçastshëm sepse ai në deklaratën e vet ka thënë se nuk e ka qëlluar të dënuarin M. aty për aty por pasi atij i ka rra vozitësi i autobusit M. S. dhe disa udhëtar të autobusit, dhe se briskun e ka nxjerr pasi është sulmuar nga këta persona, andaj, jo në momentin e sulmit nga i dënuari M. dhe jo për të zbrapsur sulmin e tij.

Nga arsyet e cekura Gjykata Supreme konstatojë se aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale siç pa bazë pretendohet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet për shkeljet e ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës

Si shkelje e ligjit penal, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë theksohet se edhe pse në aktgjykimet e kundërshtuara ceket se mjete i kryerjes së veprës penale ka qenë brisku, në shkresat e lëndës theksohet të ketë qenë thika dhe edhe pse ekziston dallimi i madhe në mes këtyre dy mjeteve, gjykatat nuk i kanë eliminuar dilemat që ka qenë e rëndësishme për të vërtetuar se mjete i përdorur a ka qenë i përshtatshëm për të krijuar dëmtime trupore të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e të dënuarit M. Sh.

Lidhur me këtë pretendim Gjykata Supreme konstatojë se në kërkesë nuk ceket se për cilën shkelje të ligjit penal nga neni 385.të KPPK behët fjalë. Megjithatë, është e evidente se në asnjë fazë të procedurës penale nuk ka qenë kontestuese se i dënuari V. ka përdorur brisk. Ashtu ka deklaruar ai dhe ashtu ka deklaruar i dënuari M. Sh. si dhe i pandehuri E. S. Nga gjetjet e ekspertit mjeko ligjor është konstatuar se lëndimet trupore të i dënuari M. Sh. janë shkaktuar me mjet mekanik të fortë mprehtës dhe kjo provë nuk ka qenë në kundërshtim me deklaratat e lartë cekura. Andaj, është i drejt konkludimi në aktgjykimet e kundërshtuara se fjala është për briskun dhe se me brisk janë shkaktuar lëndimet trupore të natyrës së rënd trupore të përshkruara në aktgjykimet e kundërshtuara ndërsa pretendimi për shkeljen e ligjit penal nuk është i bazuar.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 241/2016, më 01.11.2016.

Proçesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka